



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr : 04-353/01-42943

Data: 17.04.2025

**P r i z r e n**

**DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSIROR KK – PRIZREN,** me kërkesën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike - Prizren, me të cilën pala ka kërkuar leje për realizimin e punimeve në projektin –renovimin e sipërfaqeve rekreative-shtegu për këmbësor “Marash – Kala “ , e në bazë të nenit 3 paragrafit 1,pika 1.27,1.28 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor me Nr.04/L-174 të Dt.31.07.2013,nenit 3.1.1,1.2,1.4,1.17,1.24, e në lidhje me nenin 4 pika 1.2 si dhe nenit 5 pika 1.2 si dhe nenin 14. Pika 1.2,të Ligjit për ndërtim nr. 04/L-110, dhe sipas nenit 3 pika 1.1,1.3,1.5,1.6,1.7 dhe 1.8 e lidhur me nenin 5,8 dhe 16 të Ligjit nr.04/L-066 për Qendrën Historike - Prizren dhe të nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 27,44,46,47,48 të L,P.P.A nr.05/L-031 dt. 25.05.2016 dhe Vendimit për miratimin HZK për periudhën 2022-2030 Nr.001-011-48192 të dt 31.03.2022,merr këtë:


## **A K T V E N D I M**

**I. Aprovohet kërkesa Nr. 04-353/01-42943 e datës 08.04.2025 e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për realizimin e punimeve në projektin - renovimin e sipërfaqeve rekreative – shtegu për këmbësor “Marash- Kala”.**

**II. Dokumentacioni teknik -Projekti Kryesor i punuar nga byroja projektuese “Studio Hapsira “ Sh.P.K - Prishtinë.**

**III Datën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspektionin komunal në afat prej 8 ditësh.**

**Investitori është i obliguar që punimet të kryhen në bazë të dokumentacionit teknik-projektit e në pajtim me normat ndërtimore dhe rregullat të përkohshme teknike për kësi lloje punime .**



IV. Investitori duhet të përmbahet pëlqimit

- Vendim I QRTK-së me nr.116/2 të dt.17.04.2025

V. Pas kryerjes së punimeve Investitori është i obliguar që vend punishten menjëherë të bjerë në gjendje të mëparshme.

VI. Pas përfundimit të punimeve Investitori duhet të parashtrijë kërkesën për pranimin teknik dhe marrjen e lejes për shfrytëzim.

P.S. DSHP gjatë implementimit të projektit merr përsipër për problemet eventuale që mund të dalin lidhur me infrastrukturë dhe çështje pronësore juridike duke bërë zgjidhje sa më të mire të mundshme.

### A r s y e t i m


- Drejtoria e Shërbimeve Publike -DSHP me seli në Prizren është drejtuar këtij organi me kërkesë për realizimin e projektit - renovimin e sipërfaqeve rekreative – shtegu për këmbësor “Marash- Kala”.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit , si dhe bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110, Ligjin Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës MMPHI-së – Prishtinë.

Bashkëpunëtor profesional:

  
Afërdita Mormorina, inxh. dip. ark.



Drejtori:

  
Pranverim Berisha, jur